

Me krenari ju njoftojmë se sot, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike-ALPEX sh.a., ka nënshkruar marrëveshjen me Ofruesin e Shërbimit i përberë nga Hellenic Exchanges-Athens Stock Exchange (ATHEX), Hellenic Energy Exchange S.A. (HEnEx S.A.) dhe EnEx Clearing House S.A. (EnExClear S.A.), të cilët ne vijim do të ofrojnë Platformën e Tregtimit dhe Shërbimeve për Tregun e Ditës në Avancë dhe atë Brenda të Njëjtës Ditë, e nevojshme për operimin e Tregut të Organizuar në Shqipëri dhe Kosovë.

Sot u hodh nje gur themeli i rëndesishëm përpara integritit të tregut të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës. Misioni i ALPEX është të operojë dhe bashkojë tregjet e energjisë elektrike me shumicë, konkretisht atë të tregut të Ditës në Avancë dhe atë Brenda të Njëjtës Ditë të Shqipërisë dhe Kosovës. Për këtë qëllim dhe për integrimin e mëtejshëm me tregun e bashkuar Evropian të energjisë elektrike, në nivel rajonal dhe atë Evropian, ALPEX do të vazhdojë të punojë drejt implementimit të Modelit të Synuar Evropian (EU Target Model) për Tregun e Ditës në Avancë dhe atë Brenda të Njëjtës Ditë duke synuar të bëhet dhe Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

Operimi i tregut (go-live) është planifikuar për tremujorin e fundit të vitit 2022.

Kontakti

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike-ALPEX sh.a

Adresa: Rruga Liman Kaba, Rezidenca Olympic,
Hyrja 3, Kati 1, Zyra nr.1, Tirana, Albania.

Email: info@alpex.al